

27 - 03 - 2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin Ilir Bytyqi si dhe procesmbajtësen Kadishe Shabani, zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR] nga Fshati [REDAKTUAR], Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1167-6/17 të datës 28.08.2017, në praninë e prokurorit të shtetit Albert Zejnullahu, të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] si dhe të pandehurit [REDAKTUAR] pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik më dt. 19.01.2018, mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 29.01.2018, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: [REDAKTUAR] i lindur me [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR] e vajzërisë [REDAKTUAR], me vendbanim në Fshatin [REDAKTUAR], Komuna Ferizaj, i pa martuar, punëtor fizik, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal [REDAKTUAR]

Ë S H T Ë F A J T O R

Se me datë 26.06.2017 rreth orës 00:00, në rrugën magjistrale Suharekë-Shtime në dalje të fshati Carralevë, duke drejtuar automjetin e markës "VW Passat", ngjyrë e hiri me targa të regjistrimit [REDAKTUAR], ka vepruar në kundërshtim me nenin 54.1 të LSKRR-së, duke rrezikuar trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që nuk ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës, me vendbanim, ashtu që nga pakujdesia humb kontrollin mbi timon, kalon në shiritin e kundërt të lëvizjes dhe me pjesën e përparme e godet në pjesën e përparme automjetin e markës "Seat Cordoba", me ngjyrë të gjelbërt e me targë të regjistrimit [REDAKTUAR] të cilën e drejtonte [REDAKTUAR], me ç'rast nga kjo goditje pos dëmeve materiale në të dy automjetet, i dëmtuari [REDAKTUAR], pëson lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin të përshkruara si në ekspertizën mjeko ligjore të dt.30.07.2017.

me këtë ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të dispozitës ligjore të sipër theksuar, si dhe dispozitave ligjore nga neni 7, 8, 9, 17, 21, 41, 73, 74, 85 dhe 86 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e,

G J Y K O N

- Dënim me gjobë në shumë prej 200 Euro (dyqind), të cilën obligohet ta paguaj brenda afatit prej 1(një) muaj, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë.
- Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin brenda afatit prej 1 (një) muaj, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë, atëherë gjykata dënimin me gjobë do t'ia zëvendësojë me dënim burgimi ashtu që për çdo 20 €euro (njëzetë), të papaguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burg.
- Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor te paguaj shumën prej 20€ /njëzet euro/ si dhe shpenzimet e procedurës penale 60.88€ /njëzet euro/ në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.
- Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimin obligohet ta paguaj shumën prej 30 € (tridhjetë/euro), brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- I dëmtuarit [REDAKTUAR] nga Fshati [REDAKTUAR] Komuna Shtime, për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohen në kontest civil.

Arsyetimi

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

PTH në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1167-6/17 të datës 28.08.2017 ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR] nga Fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, duke propozuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 19.01.2018 në të cilën shqyrtim gjyqësor: *i akuzuari e pranon fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza për të gjitha pikat e saj, dhe është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, i vjen keq për këtë aksident, i kërkon falje publike të dëmtuarit, është hera e parë që ndeshet me ligjin, premtan gjykatës që në të ardhmen do të shtoj kujdesin në komunikacion, është përkujdesur vazhdimisht për shëndetin e të dëmtuarit dhe në bazë të gjithë këtyre të gjeturave i propozon gjykatës që ti ketë parasysh dhe të i shqipton një vërejtje gjyqësore.*

Prokurori i Shtetit Albert Zejnullahu duke shprehur mendimin e saj përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqipton vërejtje gjyqësore.

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së: i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe ne provat tjera te cilat gjinden ne shkresën e lendes siç janë: ekspertiza e ekspertit te komunikacionit e datës 16.07.2017, ekspertiza e mjeko-ligjore ligjor Ref-516/17 e dt. 30.07.2017, raporti mjeksor i QKMF-

Shtime e dt.26.06.2017, raporti i aksidentit me nr.2017-CFT-363 i dt.26.06.2017, deklarata e të pandehurit 26.06.2017, deklarata e të dëmtuarit 26.06.2017, si dhe fotografit që gjenden në shkresat e lëndës.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi këtë gjendje të fakteve si në vijim: me dtaë 26.06.2017 rreth orës 00:00, në rrugën magjistrale Suharekë-Shtime në dalje të fshati Carralevë, duke drejtuar automjetin e markës “VW Passat”, ngjyrë e hiri me targa të regjistrimit [REDAKTUAR], ka vepruar në kundërshtim me nenin 54.1 të LSKRR-së, duke rrezikuar trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që nuk ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës, me vendbanim, ashtu që nga pakujdesia humb kontrollin mbi timon, kalon në shiritin e kundërt të lëvizjes dhe me pjesën e përparme e godet në pjesën e përparme automjetin e markës “Seat Cordoba”, me ngjyrë të gjelbërt e me targë të regjistrimit [REDAKTUAR] të cilën e drejtonte [REDAKTUAR], me ç’rast nga kjo goditje pos dëmeve materiale në të dy automjetet, i dëmtuari [REDAKTUAR], pëson lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin të përshkruara si në ekspertizën mjeko ligjore të dt.30.07.2017.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin fillestar ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sigurtë dhe real për veprën penale

të kryer, nuk është vërtetuar se ka qenë i dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, e që këto rrethana i ndërlidhi me rrethanat personale, i pa martuar, punëtor fizik, i gjendjes së mesme ekonomike, ndera në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së


Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti Pergjithshem-Divizioni Penal,
P.nr.2178/17 datë 29.01.2018.

Zyrtare ligjore,

Kadishe Shabani

Gjyqtari: Ilir Bytyqi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.